

# **STANDARDIZATION OF CRITERIA AND PROCEDURES FOR THE MANAGEMENT OF CRIME IN ALBANIA**

**Dr. Bajram Yzeiraj**

*University "Sevasti & Parashqevi Qiriazi", Faculty of Law. Albania  
Dean of Faculty*

## **Abstract**

Crime control, because of the social risk that it poses now days, has attracted the attention of the public opinion and of the official policy within the country and in the European Union. Reforms undertaken in this area, aim to reinforce the rule of law by approximating the national legislation with that of Western Europe and also increasing the standards of law enforcement agencies in the justice system in protecting individual and society rights. In current conditions, a better management of crime and efficient development policies against it, takes special importance for our country that aspires to become associated in the European Union. Administration of crime, in a broad sense, is the process of measures and actions taken for identifying, verifying, processing, analyzing, evaluating, planning and implementing services against violations of the law which, due to social dangerousness constitute criminal offenses. Standardization and implementation of criteria and procedures for the administration of crime, is a legal obligation associated with the mission and responsibilities of state institutions to enforce the law and protect the rights and freedoms of individuals. The main goal of this article is that in the context of approximation of the legislation and policies against crime with the European Union, and of the increase in the efficiency of law enforcement, to make an analyze of the current state of crime and criminal penalty administration in Albania, and give some recommendations regarding concrete measures or change alternatives, in the relevant instrument. Strengthening the standards of crime management, in present times, will affect in a more real diagnosis and assessment of the actual state of crime and its causes, methods of crime investigation, and in the operational and institutional cooperation and consequently also in the rise of security standards toward citizens. The methodology used in this article, consists in using statistical methods and comparative analysis on current criminality and on the instruments managing it, focusing on the criteria and procedures used by the specialized institutions and those of justice; western experience and especially the needs for change in the work policy and procedures.

*Keywords:* *crime, criminal policy, research, statistics, survey, analysis, processing, planning.*

# **STANDARTIZIMI I KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PER ADMINISTRIMIN E KRIMIT NE SHQIPERI**

## **Abstrakt**

Kontrolli ndaj krimtit ne ditet e sotme per shkak te rrezikshmerise shoqerore qe paraqet, ka terhequr vemendjen e opinionit publik; politikes zyrtare brenda vendit dhe asaj Evropiane. Reformat e ndermara ne kete drejtim, synojne te perafrojne legjislacionin me ate euoperendimor; ngrejne me lart standartet e agjensive ligjzbatuse dhe sistemit te drejtesise si dhe perforcojne zbatimin e ligjit ne mbrojtje te drejtave te individit e gjithe shoqerise. Ne kushtet aktuale, administrimi i mire i kriminalitetit dhe zhvillimi i politikave eficente kunder tij, mer rendesi te veçante per vandin tone qe aspiron te antaresohet ne Bashkimin Evropian. Administrimi i krimtit ne kuptimin e gjere eshte procesi i masave dhe veprimeve qe ndermeren per evidentimin, verifikimin, perpunimin, analizimin, vleresimin, planifikimin dhe realizimin e sherbimeve kunder shkeljeve te ligjit te cilat per shkak te rrezikshmerise shoqerore perbejne vepra penale. Standartizimi dhe zbatimi i kritereve e procedurave te administrimit te krimtit, eshte nje detyrim ligjor qe lidhet me misionin dhe perjegjesite e institucioneve shteterore per zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e te drejtave dhe lirive te individit. Qellimi i trajtimit te temes eshte qe ne kuadrin e perafrimit te legjislacionit dhe politikave kunder krimtit me ato te Bashkimit Evropian, si dhe ritjes se eficences se zbatimit te ligjit, te analizojme gjendjen aktuale te administrimit te krimtit ne Shqiperi me problematiken perkatese dhe njehersh te japim disa rekomandime per masat dhe alternativat e ndryshimit te instrumentave perkates. Perforcimi i standarteve te administrimit te krimtit ne kushtet qe kalojme, do te ndikoje ne diagnostikimin dhe vleresimin me real te gjendjes se krimtit e shkaqeve te tij; ne metoden e investigimit te krimtit; bashkepunimin operacional e ate nderinstitucional e per rjedhoje edhe ne ritjen e standarteve te sigurise se qytetareve. Metodologja e trajtimit te temes konsiston ne perdonimin e metodes statistikore dhe analizes krahasuse mbi kriminalitein aktual dhe instrumentat e administrimit te tij, duke u ndalur tek kriteret e procedurat qe perdonin institucionet e specializuara e ato te drejtesise; pervoja perendimore dhe veçanarisht nevojat e ndryshimit te politikave e procedurave te punes.

Fjalet kyce: krimi, politika kriminale, administrimi, kritere, rregulla, procedura, standarte, studimi, statistika, anketimi, menaxhimi, analiza, perpunimi, planifikimi, organizimi, kontrolli.

- 
- (1) Dekan i Fakultetit te Drejtesise - Shkolla e larte Universitare Jopublike “Sevasti & Parashqevi Qiriazi”

## Hyrje

Politika kunder krimtit eshte pjese perberese e veprimtarise shteterore dhe njeheresh edhe disipline shkencore qe studjon problemet dhe strategjite e luftes kunder krimtit. Objekti i studimit te saj perqendrohet tek legjislacioni penal e ai procedural penal; standartet e institucioneve ligjzbatuse e atyre te sistemit te drejesise; si dhe programet e strategjite e punes per kontrollin ndaj krimtit. Gjate periudhes se tranzicionit pervec ritjes se vellimit te krimtit, u persos organizimi dhe bashkepunimi i grupeve kriminale brenda e jashte vendit; nderthur veprimtaria kriminale me ate te sipermarjes private; zhvilluan trafiqt e ndryshme; shtua komunikimi, metodat dhe levizshmeria e tij; zhvillua me hapa te shpejte korupsioni dhe bashkepunimi me punonjesit e shtetit e ata te drejesise etj. Zhvillimi i nje politike te suksesshme kunder krimtit ne kushtet e sotme, kerkon administrim te mire te tij, si dhe diagnostikim te faktoreve e shkaqeve qe ndikojne. Ne kuptimin e per gjithshem administrimi i krimtit eshte nje proces i gjere qe perfshin masa dhe veprime te karaterit shteteror e shoqeror per evidentimin, verifikimin, perpunimin, analizimin e vleresimin e gjendjes se krimtit si dukuri; si dhe reagimin me masa e sherbime komplekse kunder tij. Ne kuptimin e ngushte ky proces nenkupton administrimin e veprave penale prej institucioneve per gjegjese nga momenti i kryerjes se tyre dhe gjate gjithe fazave te zhvillimit te drejesise penale.

## I. Infrastruktura per evidentimin dhe administrimin e krimtit

### 1. Evidentimi i krimtit

Nevoja e mbledhjes dhe mbajtjes te statistikave te sakta mbi krimin ne menyre te centralizuar, ku perfshihen (te dhenat e Policise, gjykatave dhe institucioneve te ekzekutimit te denimit) eshte shtruar qe ne periudhen e mesjetes, ku sociologe e juriste te ndryshem te asaj kohe, kerkonin qe krimi te administrohej, studiohej e njihej me mire per te evidentuar faktoret dhe shkaqet qe ndikonin ne zhvillimin e tij. Shume prej tyre evidentonin si faktorin kryesor te krimeve, gjendjen social-ekonomike, ndaj dhe rekomandonin parandalimin duke zbutur pikerisht keta faktore. (2)Statistikat e para kombetare mbi krimin jane prodhuar ne France ne fillim te shek.XIX nga Adolph Quetelet ne vitet 1796-1874, dhe Francas Guerry de Champneuf ne vitet 1802-1866. Duke qene se keto statistika linin jashte vetes nje pjese te krimtit qe quhet "shifra e erret", Laccasogne ne 1834-1924 dhe Tarde ne periudhen e viteve 1834-1904, themeluan analizen statistike te krimtit duke bere nje vezhgim me te plote te kriminalitetit.(3) Ne rapport me shtrirjen dhe qellimin, statistikat mbi krimin i ndajme ne:

- Statistikat nderkombetare, te cilat pasqyrojnë gjendjen e krimtit ne nivel boteror, kontinental apo rajonal dhe si te tilla krijohen e administrohen nga institucione e organizma te

Organizates se Kombeve te Bashkuara, te Keshillit te Europees ose organizma rajonale. Keto organizata nderkombetare ne berjen e studimeve dhe analizave bashkepunojne me institute, eksperte e organizma te specializuara. (4)

- b) Statistikat kombetare ose nationale, te cilat pasqyrojne gjendjen e krimtit ne nje vend ose shtet te caktuar. Keto mund te jene te per gjitheshme ose te vecanta apo fragmentare dhe

-----  
(2) Willians, K: Textbook on criminology, Oxford 2001, f.75.

(3) Muncie, J: Official criminal statistics, bot. "The sage Dictionary of Criminology" 2001.f.195

(4) Komiteti Evropian per problemet e krimtit; Komiteti i eksperteve ligjore e te krimtit te organizuar; Komiteti per parandalimin e tortures dhe trajtimit cnjerezor; Instituti Evropian per parandalimin e krimtit; Qendra e kerkimeve per krimin transnacional; Qendra per informim dhe studim te krimtit te organizuar; bashkimi i vendeve te detit te zi; vendet e Europees juglindore SECI; vendet qe lagen nga deti Adriatik e Jon etj;

mbahen nga cdo shtet per te njojur e administruar gjendjen e krimtit brenda vendit si dhe ndertuar politikat e parandalimit e goditjes se tij. Ne kushtet e globalizimit dhe ekonomise se tregut te lire, ku levizshmeria e krimtit dhe kryeresve te tij eshte e madhe, eshte e nevojshme jo vetem te perafrohet legjislationi me ate euoperendimor, por dhe harmonizohen kriteret e regjistrimit te krimtit dhe procedurat e bashkepunimit.

Standartizimin e kritereve e procedurave te administrimit te krimtit e diktojne:

- a) Faktoret e brendshem, nder te cilet duhen vecuar per gjegjesite dhe detyrimet e percaktuara nga legjislationi si Kushtetuta, ligji penal dhe ai procedural penal, ai per Policine e shtetit, Policine gjyqesore, Prokurorine, organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqesor, statistikat zyrtare etj, te cilet percaktojne per gjegjesite, procedurat e afatet kohore per administrimin dhe investigimin e krimtit. Zhvillimi i drejtisise penale dhe politikes kriminale ne teresi eshte nje proces kompleks, ku marin pjesa shume institucionale e organizma, te cilet e kane te domosdoshme te realizojne kordinimin brenda strukturave te veta si dhe bashkepunimin nderinstitucional brenda e jashte vendit. Vecorite e kriminalitetit dhe faktoreve kriminogjene si dhe programet shteterore te hartuara per parandalimin e krimtit ne teresi apo llojeve te vecanta te tij si ndaj krimtit ne familje, trafiqeve te ndryshme dhe korupsionit etj, shtrojne nevojen e njojves dhe administrimit me per gjegjesi te tij nga institucionet per gjegjese.
- b) Faktoret e jashtem (nderkombetare), ku perfshihen konventat, protokollet, vendime kuader, rekomandimet, organizmat e bashkepunimit policor dhe gjyqesor; (5) projektet, marrëveshjet, studimet e botime etj, te cilet orjentojnë dhe shtrojne detyrimet per zhvillimin e politikave te perbashketa dhe bashkepunim ne luften kunder krimtit, sidomos ndaj atij te organizuar dhe korupsionit. (6)

Komiteti i ministrave te Keshillit te Evropes ne rekomandimet e dhena per politiken kriminale ne per gjithesi apo ate kunder krimit te organizuar e formave te vecanta te tij, shprehet se:

---

(5)- Konventa e OKB “ Per luften kunder krimit te organizuar nderkombetar” me dy protokollet shtese; ajo per luften kunder terrorizmit; kunder droges; pastrimit te parave etj;

- Konventa Evropiane dhe protokolli “Per ndihme te ndersjellte juridike ne ceshtjet penale midis shteteve antare te BE” 2000, “Per ekstradimin” dhe ajo e thjeshtimit te procedurave te ekstradimit midis shteteve anetare te BE (1995), “Per pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve te krimtit”; “Per trasferimin e procedimeve ne ceshtjet penale”; “Per ekstradimin”; rezoluta “Per parandalimin dhe kontrollin e krimtit te organizuar” me 39 rekomandime etj.

- Interpoli, (org. nderk. e Policise kriminale; shkembet informacion e kordinon per luften kunder krimtit te organizuar, ndermer studime e kerkime ne fushen e kriminalitetit; vendi yne u pranua ne dhjetor 1991;

- Europoli, (org. qendore e policise kriminale Europeane); u krijuar ne shkurt 1992 ne Maastricht – Hollande; tashme nje agjensi e BE per shkembim informacioni dhe informatizim, atrim raportesh e analizash; bashkepunim dhe parandalim te terrorizmit, tragikut te droges e krimeve te renda);

- Cepoli, (European Police College) eshte krijuar nga Keshilli i BE ne vitin 2000, per te ndihmuar ne trainimin dhe bashkepunimin e institucioneve kombetare dhe adresimin e ceshtjeve qe lidhen me luften kunder krimeve me karakter nderkufitar,

- Eurojust, (Agjensi e bashkepunimit gjyqesor European) eshte krijuar ne vitin 2002 per te ndihmuar ne luften kunder krimtit te organizuar , per procedimin dhe hetimin e ketyre ceshtjeve me efektivitet; si dhe nje interlokutor per Keshillin, Parlamentin dhe Komisionin e BE.

- European Judicial Network, (Rjeti gjyqesor European) eshte organizem per te kordinuar bashkepunimin gjyqesor midis shteteve antare te BE.

”.. duhet te behen analiza, studime e kerkime shkencore, me qellim qe te gjenden e aplikohen mjetet e alternativa te efektshme parandalimi..” (7); “..eshte e nevojshme bashkepunimi i institucioneve te zbatimit te ligjit e atyre te drejtësise me organet homologe perendimore..” (8)

Sa jane te harmonizuara kriteret, rregullat dhe procedurat e administrimit te krimtit me ato euoperendimore dhe sa u mundesojne keto institucioneve per gjegjese per zhvillimin e politikes kriminale? Pergjigja kerkon berjen e nje analize krahasuese midis infrastruktureve e metodologjisë se veprimit dhe problematikese qe haset ne veprimtarine e perditeshme.

## **Institucionet perjegjese per administrimin e krimit**

Statistikat e krimit mbahen dhe administrohen nga organet shteterore te specializuara per te njohur e vleresuar gjendjen e krimit dhe reaguar me sherbimet parandaluse e investiguese ne funksion te sigurise se individit e shoqerise. Ato klasifikohen ne menyra te ndryshme sipas natyres se tyre (numuri, llojet e tj); sipas burimit institucional (te Policise, Prokurorise, Gjykates, Burgjeve, ministise se brendeshme, te drejtesise, instituti i statistikave etj) dhe sipas origjines e shtrirjes se tyre (lokale, prefekture, kombetare, nderkombetare, shkencore etj).

**Statistika e Policise** permbanveprat penale te ndodhura ne nje kohe te caktuar. Ajo plotesohet dhe administrohet nga strukturat perkate se disa nivele sipas vendit te kryerjes se kimeve dhe sipas llojeve apo drejtimeve te veprimtarise kriminale. Ne permbajtjen e tyre gjejme te dhena mbi vellimin e per gjithshem te kimeve, strukturen e tyre, rezikshmerine, dinamiken, vendin, kohen, tendencen etj per nje periudhe kohe te caktuar; autoret e kryerjes se kimeve e viktimat dhe karakteristikat e tyre si gjinine, moshen, arsimin, poziten ligjore, sociale, familjare etj. Kjo statistike eshte me afer realitetit si per vellimin e per gjithshem te kimeve, ashtu edhe per strukturen e llojet e ndryshme te tij.

Ne difektet e kesaj statistike evidentojme:

- a) Mosrespektimin e pote te kritereve ligjore ne evidencimin, klasifikimin dhe administrimin e kimeve. Statistika aktuale ne fillim ben grupimin dhe klasifikimin e veprave penale duke u bazuar ne objektin e mardhenieve qe prekin (sipas ligjit penal); me pas e ndryshon kete kriter i grupon ato sipas strukturave qe i ndjekin, duke krijuar konfuzion dhe pasaktesi per gjendjen reale te krimit; b) mospasqyrimin e disa veprave penale te fushes ekonomike, asaj ushtarake, si dhe atyre qe ndiqen mbi baze ankimimi, te cilat institucionet dhe subjektet
- 

(6)- Programi OCTOPUS per te ndihmuar vendet ish komuniste ne luften kunder krimtit te organizuar dhe korupsionit; programi CARDS per ndihmen ndaj vendeve te Europees juglindore per forcimin e Policise dhe gjyqesorit; programi Greco (gruoi i shteteve kunder korupsionit) per te luftuar korupsionin ne 35 shtete; - Programi PAMECA qe perfaqeson Bashkimin European dhe kontribon per zhvillimin e Policise se shtetit; ICITAP qe kontribon me programin e assistences per hetimin kriminal; INTERFORCE qe meret me ndalimin e trafikut te qenjeve njerezore e klandestineve etj. - Libri Evropian "Per krimin dhe drejtesine penale "European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics", Ky botim pervec pasqyrimit te tregusve te krimtit dhe denimit penal ne cdo shtet, evidenton vecorite, tendencat, shkaqet dhe nxjer konkluzione e rekomandime shume te vlefshme.(7) - Rekomandimet e Komisionit per parandalimin e krimtit dhe sistemin e drejtesise (2005/23), kerkon forcimin e raportimit te krimtit. Rekomandim i Kom. te ministrave te Ksh. Evropes nr.96-8 "Per politiken kriminale ne Evrope" 1996. Ai permban

drejtimet kryesore ne te cilat duhet te bazohet politika kriminale e shteteve antare te Keshillit te Europees.

(8) Rekomandimi i Kom. Ministrave te Ksh. Europees nr. (87) 19 “Per parandalimin e krimtit te organizuar” perkatese i dergojne vete ne Prokurori; c) mungesen e mjaft krimeve qe nuk denoncohen nga shtetasit per motive te ndryshme, ose nuk evidentohen nga vete punonjesit e Policise (krimi i erret); ç) pasaktesine ne tregues per shkak te ndryshimit te kualifikimit te veprave penale gjate kalimit ne Prokurori e me pas ne Gjykatë; d) pasaktesi ne evidentimin e veprimtarise te nje personi i cili ka kryer disa vepra penale, ose nje veper ne menyre te vazhdushme; dh) mosperpunim te saj dhe nxjerje te konkluzioneve perkatese etj, probleme keto qe lidhen me pasaktesine dhe konfuzionin qe ekziston ne kriteret, procedurat dhe metodologjine e administrimit. (9)

**Statistika e Prokurorise** ka per baze çeshtjet penale te filluara, pra per ato qe eshte hapur procedimi penal. Ato permbajne te dhena mbi procedimet penale te filluara, ato te rifilluara dhe vendimet perkatese per pushim, pezullim, dergim ne gjykate; si dhe te dhena mbi personat ndaj te cileve kane filluar hetimet e atyre qe kane lidhje me procedimin penal. Ne to gjenden te dhena mbi masat e sigurise, afatet e procedimit, ekzekutimit te vendimeve, trasferimet e procedimeve, ekstradimet etj. Krahasuar me ate te Policise kjo statistike administron ne total me shume ceshtje penale, e per rjedhoje edhe me shume vepra penale sepse perfshin edhe çeshtjet e filluara kryesisht nga ky organ, ato te derguara nga kontrolli i larte i shtetit e agjensi te tjera qe kane atributet e policise gjyqesore. Ne aspektin juridik te dhenat e statistikes se Prokurorise jane me te sakta e cilesore se ato te Policise, sepse ky institucion ben vleresimin per elementet e vepres penale dhe vendos fillimin ose jo te çeshtjes. Ne kete statistike gjejme te plete e te diferençuar numurin e procedimeve penale te filluara dhe ate te veprave penale te kryera nga i njejt person ose disa persona, gje qe na ndihmon shume ne vleresimin e tregusve te kriminalitetit dhe ndertimin e politikave te reagimit. Megjithate ajo nuk permban plotesisht gjendjen reale te kriminalitetit, sepse i mungojne shume krime sic jane ato qe Policia i ka ne proces pune si dhe ato qe nuk denoncohen; si dhe ka me pak te dhena se sa administron Policia e shtetit. (10)

**Statistika e Gjykates** ka per baze çeshtjet e gjykuara. Ajo permban te dhena rreth çeshtjeve penale te regjistruara, astyre te gjykuara, te pushuara, vendimeve te fajesise ose te pafajesise, personave te denuar, llojeve te denimit etj. Te dhenat e kesaj statistike persa i perket numurit te pergjithshem te krimeve, klasifikimit te veprave, autoreve te krimtit dhe demtuarve, dallojne nga ato te institucioneve qe kane perqatitur dosjet, per shkak te afateve proceduriale, provave te dala gjate procesit te gjykimit etj. (11)

**Instituti i statistikave** administron te dhenat vjetore kryesore mbi kriminalitetin, autoret dhe te demtuarit qe grumbullon nga ministrite perkatese, por keto nuk jane gjithmone te regullta, te plota dhe aktuale qe mund te ndihmojne per berjen e studimeve e nxjerjen e konkluzjoneve. Sic shihet institucionet evidentojne te dhenat mbi krimin per aq sa u takon dhe asnje prej tyre

perfshire edhe institutin e statistikave nuk administron te gjithe tregusit e krimit, strukturen, tendencat dhe karakteristikat e tij.

---

(9) Statistika e Policise se shtetit 2011-2012

(10) Raporti vjetor i Prokurorise,

(11) Vjetari statistikor i M. Drejtesise

## **II. Studimi, analiza dhe vleresimi i krimit**

### **1. Studimi i krimit**

Studimet mbi kriminalitetin jane pjese perberese e politikave kunder krimtit dhe si te tilla ato u paraprijne qendrimeve dhe zgjidhjeve politike. Ne studimet nderkombetare mund te vecojme:

- a) Studimin “Per tendencat e krimtit dhe veprimet e sistemeve te drejtesise penale”(12),
- b) Raportin global te Kombeve te Bashkuara per krimin dhe drejtesine (13),
- c) Botimin “Per krimin dhe statistikat e sistemit te drejtesise penale” (14)Ne keto studime ku perfshihet edhe vendi yne, behen verejtje per nivelin e ulet te raportimit (pergjigjes) per pyetjet e shtruara; konceptet e ndryshme mbi kriteret dhe standartet nderkombetare te perdonura nga studjusit; mungesen e informatizimit dhe standartizimit te statistikave; metodologjine e mbledhjes dhe perpunimit te dhenave mbi krimin etj; te cilat shtrojne nevojen e standartizimit te kritereve e procedurave te administrimit te krimtit ne te gjitha fazat e zhvillimit te drejtesise penale. Shkaqet e kesaj gjendjeje duhen kerkuar tek ndryshimet e shpeshta te legjislacionit penal; difektet e sistemit statistikor i cili nuk eshte sipas standardeve qe qe kerkojne studimet krahasuse; mungesa e te dhenave per grupe te ndryshme shoqerore; moskolaudimi i te dhenave midis strukturave dhe institucioneve etj. (15) Krimi si cdo dukuri shoqerore, mund te njihet e mbahet nen kontroll, nese studjohet me te gjithe elementet perberes dhe vecorite qe paraqitet, ku perfshihen: a) tregusit mbi krimin dhe karakteristikat e tij b) ata mbi autoret dhe viktimat e krimtit me karakteristikat perkatese; c) faktoret dhe shkaqet qe ndikojne etj. Nenvleftesimi i studimit dhe njohje te elementeve te mesiperm ndikon negativisht ne njohjen e gjendjes dhe rrezikshmerise se tij, ne diagnostikimin e shkaqeve, e per rqedhoje edhe ne eficencen e politikave kunder tij.

---

(12) Ky studim bazohet ne statistikat zyrtare mbi krimin dhe synon te njohe gjendjen e krimtit ne nivelin global, strukturen, tendencat dhe karakteristikat e tij; te evidentoje faktoret dhe shkaqet; si dhe harmonizoje statistikat ne nivel nderkombetar. Studimi ne anglisht: United Nations Survey of Crime Trends and Operations of Criminal Justice System (CTS). Rezultatet e 10 studimeve nderkombetare jane ne internet me adresë: <http://www.unodc.org/unodc/endata-and-analysis/United-Nations-Surveys-on-Crime-Trends-and-the-Operations-of-Criminal-Justice->

Systems.html.(13) Raporti global i Kombeve te Bashkuara per krimin dhe drejtesine afron te dhena per vellimin e krimit dhe aspekte te ndryshme te tij si dhe drejtesine penale per cdo shtet. Aty jepen te dhena pershkruse dhe krahasuse per krimin e organizuar, respektimin e ligjit, shkeljet e ligjeve dhe menyren e procedimit te personave qe shkelin ligjin, lidhjet e mundeshme mes krimit dhe zhvillimeve ekonomike, moshes dhe gjinise se autoreve, te drejtat e njeriut dhe drejtesine, eficencen dhe drejtesine ne sistemin e drejtesise penale etj. Shih Graeme Newman, Advances in Comparative Criminology: United Nations Global Report ON Crime and Justice, botuar ne "Surveying Crime: A Global Perspective", permblehdhe e punimeve te koferences Nderkombetare ne Rome me 19-21 nentor 1998, botim UNICRI, INSTAT, Itali Assays, vell.nr.7 ,2000, f.53-62(14) Libri i Ksh.te Europees "Per krimin dhe statistikat e sistemit te drejtesise penale" , behet mbi bazen e pyetsorit qe u dergohet korespondenteve ne sejcilin shtet, anetar te Keshillit te Europees. Ai analizon gjendjen e krimtit, tendencat, politiken e denimit penal dhe nxjer konkluzionet perkatese ne nivel europian, rajonal dhe per cdo vend te vecante. Shih European Sourcebook Group: Second European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics, botuar ne criminology in Europe, newsletter of the European Society of Criminology, vell.3, nr.3, 2004, f.15-17. Botimi i 2006: [http://openlibrary.org/b/OL21187560M/European\\_of\\_crime\\_and\\_criminal\\_justice\\_statistics\\_2003](http://openlibrary.org/b/OL21187560M/European_of_crime_and_criminal_justice_statistics_2003)(15) V.Hysi Libri europian per krimin dhe statistikat e drejtesise penale-nje aritje ne fushen e kriminologjise se krahasuar, revista Studime juridike nr.1 viti 2001 f.53-69.

Njohja e krimtit mund te realizohet nepermjet :

- a) Administrimit te mire te statistikave te krimtit (evidentim, perpunim, analize dhe studim), nga institucionet perjegjese (Polici, Prokurori, M. Brendeshme, M. drejtesise) me strukturat e e specializuara te analizes e studmit. Evidentimi rigoroz e me metodologji te qarte i krimtit i shoqeruar me perpunimin e te dhenave e informacionit te grumbulluar, do te çoje ne nxjerjen e te dhenave te tjera e karakteristikave si dhe ne zbulimin e shkaqeve sipas drejtimeve ao vendeve te shfaqjes. Ne kete proces duhet te angazhohen te gjitha strukturat qe meren me parandalimin dhe investigimin e krimtit, por vecanarisht sektoret dhe zyrat e analizes e studimit te ngritura brenda institucioneve ligjzbatuse e atyre te drejtesise.
- b) Ndermarjes te Studimeve te posacme mbi krimin ne teresi apo lloje e forma te vecanta te tij, sic mund te jete ai brenda familjes, ne fushen e droges, korupsionit etj. Ketu perfshihen edhe anketimet e opinionit publik per probleme te krimtit ose lloje te vecanta te tij, per te terhequr mendimin e qytetareve reth gjendjes, shkaqeve, nivelit te sherbimeve, mjeteve qe duhen perdonur per parandalim etj.

## 2. Analiza dhe vleresimi i krimtit

Objekti trajtimit ne kete teme eshte analiza strategjike mbi krimin, e cila eshte perjegjesi e institucioneve te larta shteterore (Presidence, Kuvend dhe Qeveri) me organizmat e posacme qe funksionojne prane tyre, si (Keshilli i sigurise, Komisioni i sigurise dhe Komiteti i sigurise).

Analiza dhe vleresimi i krimit, per rjedhoje dhe nivelit te sigurise nga faktoret politikeberes duhet bazuar ne studimin dhe ballafaqimin e tregusve reale te krimit ne nivel kombetar me legjislacionin, strategjite shteterore te miratuara dhe vleresimin e komunitetit.Ne vleresimin e krimit dallohen dy pikpamje e qendrime. Njera vlereson si krime, vetem veprat penale te cilesuara te tilla nga ligji penal; ndersa tjetra e trajton me gjere problemin duke quajtur “krim” cdo veper penale te ndodhur, pavaresisht nga percaktimi i ligjit, evidentimi, zbulimi e ndeshkimi. Keqinterpretimi i problemit ne analiza, duke paraqitur vetem shifrat e krimeve e lene jashte vemendjes veprat e tjera penale (kundravajtjet penale), apo duke heshtur per tendencen e ritjes se vellimit te per gjithshem te veprave penale, ka krijuar konfuzion brenda strukturave shteterore dhe ne opinionin publik.

Tradita e krijuar ne zhvillimin e analizave vjetore nga Policia e shtetit ne mjedise publike me argumentin e “trasparences ndaj opinionit publik”; duke paraqitur vetem sukseset e luftes kunder krimit dhe anashkaluar difektet e punes, ankesat e komunitetit e vecanarisht shkaqet e kriminalitetit, ka ndikuar negativisht jo vetem ne njohjen e gjendjes e nxjerjen e per gjegjesive, por edhe ne percaktimin e prioriteteve te punes e angazhimin kunder krimit. Analiza e bere nga Prokuroria e republikes ne raportet e saj vjetore per Kuvendin, permban tre probleme te cilat lidhen me per gjegjesite ligjore dhe kane te bejne me: a) gjendjen e krimit, karakteristikat, shkaqet dhe tendencat e tij; b) tregusit e punes per hetimin dhe zbatimin e ligjit ndaj autoreve te krimeve; c) prognozen e krimit dhe drejtimet e punes per te ardhmen. Ne kete analize qe i nenshtrohet gjykimit e vleresimit nga te zgjedhurit, behet pasqyrimi me objektivitet e profesionalizem i gjendjes se krimit, tendencies se ritjes, shkaqeve etj duke dhene dhe rekomandimet perkatese.Ne Vjetarin statistikor te hartuar dhe publikuar nga Ministria e drejtisise per çdo vit, jepen te dhena edhe mbi çeshtjet penale te gjykuara nga sistemi gjyqesor, denimet e dhena dhe ekzekutimin e tyre. Publikimi ne internet i tregusve te çeshtjeve te gjykuara dhe denimeve te dhena, jo vetem informacion komunitetin per keto probleme kaq te ndjeshme, por dhe krijon mundesine per njohje e studime te problemeve te ndryshme qe lidhen me politiken penale ne vendin tone.Institucionet shteterore te specializuara dhe ato te drejtisise per te vleresuar krimin dhe politiken penale ne nivel strategjik (kombetar), duhet te bashkojne te dhenat duke bere harmonizimin e perpunimin e tregusve dhe unifikimin e konkluzioneve. Tregusit kryesore qe duhen unifikuar nga institucionet jane vellimi i per gjithshem i kriminalitetit te regjistruar, numri i kryeresve te tij dhe njerzve te viktimizuar; rapporti i krimit me numrin e banoreve; struktura e kriminalitetit sipas llojeve, duke diferencuar krimin e dhunshem nga ai i organizuar;rrezikshmeria e krimeve; shtrirja gjeografike; tendanca e krimit; perqindja e zbulimit, denimet e dhena nga drejtesia etj.Ndryshimet midis institucioneve ne paraqitjen dhe vleresimin e gjendjes se krimit duken nese krahasojme te dhenat e Policise se shtetit me ato te Prokurorise. Statistika e Policise e vitit 2008 e krahasuar me ate te vitit 2011 (kater vjet), evidenton ritje te vellimit te krimit 29%; te numrit te autoreve 35%, te viktimave rreth 50%. Raporti i Prokurorise per te njejten periudhe evidenton ritje te numrit te çeshtjeve te regjistruara 13%, numrit te çeshtjeve te hetuara 17 %. Ndryshime duket edhe ne vleresimin e struktureve se veprave penale

dhe rezikshmerine e tyre, ku sipas Policise, vendin e pare ne vellimin e per gjithshem te veprave penale e zene veprat penale kunder jetes, shendetit e sigurise se personit; ndersa sipas Prokurorise jane veprat penale kunder pasurise e ekonomise. Edhe per ritjen e fuqise zbuluse e ndeshkuse raportimet jane te ndryshme ku Policia jep ritje te zbulimit te krimtit cdo vit, ndersa Prokuroria raporton per kater vitet e fundit ritjen me 69% te numrit te ceshtjeve penale te pezulluara. Per rjedhoje edhe konkluzionet qe terhiqen e vleresimet qe behen jane me drejtime te ndryshme. Te njejtin konkluzion mund te nxjerim edhe per krimin e organizuar, ku Policia vazhdon te vleresoje gjendjen sipas shifrave te reportuara nga strukturat e saj, jashte kritereve ligjore dhe kolaudimit te te dhenave me prokurorine e gjykaten. Perdorimi i kritereve te ndryshme per klasifikimin dhe vleresimin e ketij krimi, ka ndikuar jo vetem ne nxjerjen e konkluzioneve te gabuara por dhe ne nje fare vetkenaqesie te pabazuar per rezultatet e punes.

### **Disa konkluzione e rekomandime**

Administrimi i krimtit nga institucionet per gjegjese dhe sistemi i drejtesise vazhdon te behet ne menyre te njeaneshme e sektoriale. Per rjedhoje institucionet vendimarese ne nivel kombetar vleresojne statistikat e dhena nga Policia e shtetit, te cilat nuk jane te plota e harmonozuara me sistemin e drejtesise. Kriteret, procedurat dhe metodologja e regjistrimit e administrimit te krimtit ende nuk jane te unifikuara e konsoliduara, cka le shkas per interpretime e zbatime te ndryshme ne veprimtarine praktike brenda e midis institucioneve. Edhe studimi e analiza e krimtit nga organet shteterore dhe shoqeria civile vazhdojne te behen ne menyre te njeaneshme e fragmentare. Opinion publik gjate tranzacionit nuk eshte njojur me ndonje studim te plete per kriminalitetin, vecorite e tij dhe shkaqet qe ndikojne. Ne studimet e bera nga organizmat nderkombetare, pala shqiptare per shkak te veshtiresive ne infrastrukturen e administrimit te krimtit nuk ka mundur te raportoje per te gjitha rubrikat dhe pyetjet e shtruara, cka ka veshtiresuar prezantimin e gjenjdes. Analiza dhe vleresimi i krimtit vazhdon te behet me nota pozitive, duke shmangur te metat, tendencat e ritjes dhe shkaqet qe ndikojne. Difektet ne kete proces pune te institucioneve shteterore jane rjedhoje e boshlqeve ne legjislacion e sidomos ne aktet nenligjore; mentalitetit dhe praktikes se vjeter te trasheguar nga e kaluara; mangesive ne bashkepunimin nderinstitucional; mosinformatizimit te gjitheprocesit te drejtesise penale; si dhe lufte kunder krimtit larg studimit e menaxhimit shkencor.

Nryshimi i standarteve per administrimin e krimtit kerkon:

- Studimin e te gjitha fazave te administrimit te krimtit ne procesin e drejtesise penale, per gjegjesive te institucioneve dhe praktikave te punes; udhezimeve te politikes nderkombetare dhe berjen e ndryshimeve te duhura ne aktet ligjore dhe metodologjine e punes,
- Ndryshimin e rregullave per evidentimin e veprave penale ne gjithe sistemin e policimit; berjen e informatizimit te tyre; si dhe te analizave e vleresimit insitiucional, me qellim qe veprimtaria te jete e kontrollushme dhe e mateshme.

- Ngritjen e nje instituti te vecante per studime kriminologjike, i cili do te mund te beje studime e rekomandime mbi baza shkencore per kete dukuri me rrezikshmeri shoqerore.
- Shtimin e trasparencës me opinionin publik mbi tregusit e krimit e shkaqet e tij, si dhe te botimeve informuese per opinionon e brendshem dhe ate nderkombetar.

## **Bibliografia**

- Politika kriminale Elezi. I, Hysi. V,
- Korupsioni, veprat penale perberese, krimi i organizuar, Gjonca. L,
- Statistikat vjetore te krimtit te Policise se shtetit 2008-2012,
- Raportet vjetore te prokurorise se per gjitheshme per ne kuvend 2009-2011,
- Vjetaret statistikor te Ministrise se drejtësise 2008- 2010,
- Ligji nr. 8417 date 21.10.1998 Per Kushtetuten, i ndryshuar,
- Ligji nr. 7895 date 27.01.1995 Per Kodin penal te Republikës se Shqiperise, i ndryshuar
- Ligji nr. 7905 date 21.3.1995 Per Kodin e procedurës penale, i ndryshuar,
- Ligji nr. 9877 date 18.02.2008 Per organizimin e pushtetit gjyqesor,
- Ligji nr. 8737 date 12.2.2001 Per Prokurorinë e Republikës,
- Ligji nr. 8677 date 2.11. 2000 Per policine gjyqesore, i ndryshuar,
- Ligji nr. 9749 date 06.04. 2007 Per Policinë e shtetit,
- Ligji nr. 9180 date 05.02. 2004 Per statistikat zyrtare,
- Ligji nr. 9284 date 30.9.2004 Per parandalimin dhe goditjen e krimtit te organizuar
- Konventa Europiane e te drejtave dhe lirive themelore te njeriut, ligji nr. 8137 date 31.7.1996
- Konventa per ekstradimin dhe dy protokollet shtese, ligji nr. 8322 date 2.4.1998
- Konventa Ksh. Europee per trasferimin e procedimeve penale, ligji nr. 8497 date 10.6.1999
- Konventa Ksh. Europee per ndihmen e ndersellët juridike, ligji nr. 8498 date 10.6.1999
- Konventa e OKB Per te drejtat e femijeve, ligji nr. 1992
- Konventa e OKB "Kunder krimtit te organizuar nderkombetar", ligji 8920 date 11.7.2002
- Rekomandimi "Mbi parimet baze te luftes kunder krimtit te organizuar" 2001(11)
- Rezoluta "Per parandalimin dhe kontrollin e krimtit te organizuar" me 39 rekomandime etj.
- Rekomandimi i komitetit te Ksh. ministrave nr. 96-8 "Per politiken kriminale ne Evropë"(1),
- Vendimi per "Programin kuader te bashkepunimit Policor dhe Gjyqesor per çeshtjet penale".